

Tarifat e Albinspekt bio.inspecta

1. Tarifat për shërbimin e inspektim/çertifikimit për standartet kombëtare

Shërbimet e ofruara	Kosto (Lek) / Njësi	Njësia
Inspektim (Rregulloret organike) (Përgatitje për inspektim; inspektimi në terren; shkrimi i raporteve)	20.000	Për ditë ¹
Inspektim Hallall (Përgatitje për inspektim; inspektimi në terren; shkrimi i raporteve)	30.000	Për ditë
Kosto e udhëtimit:	6.000	Për ditë
• Koha e udhëtimit		
• transport siguruar me mjetin e Albinspekt	35	Për kilometër
• transport siguruar me mjete publike	Kostot aktuale të tregut	Fatura e transportit
• Marrje Kampioni	20.000	Për ditë
• Njohje Retroaktive	20.000	Për dite
Çertifikimi (Rregulloret organike)	20.000	Për ditë
Çertifikimi Hallall	30.000	Për ditë
Çertifikata e produktit (për çdo certifikatë shtesë origjinale të kërkuar; përfshirë publikimin në faqen e internetit)	2.000	Për certifikatë
Teste / Analiza	Kostot aktuale të tregut	Toka / Bimët / Produktet
Administrim	5 % e shumës totale	
Shpenzime të tjera shtesë	1.000	Akomodim, shpenzime për ushqim, etj. për inspektorët
	3 % e shumës totale	Për çdo shtyrje të datës së caktuar të inspektimit

Shënim: TVSH nuk është e përfshirë në tarifat e mësipërme.

2. Tarifat për shërbimin e inspektim/çertifikimit për standartet ndërkombëtare²

Shërbimet e ofruara	Kosto (EUR) / Njësi	Njësia
Tarifat për shërbimin e inspektimit (SOA, bi-OS, NOP, Bio Suisse)		
Inspektim (Përgatitje për inspektim; inspektimi në terren; shkrimi i raporteve)	300	Për ditë
Kosto e udhëtimit:	60	Për ditë
• Koha e udhëtimit		
• transport siguruar me mjetin e Albinspekt	0.25	Për kilometër
• transport siguruar me mjete publike	Kostot aktuale të tregut	Fatura e transportit
Marrje Kampioni	300	Për ditë
Teste / Analiza	Kostot aktuale të tregut	Toka / Bimët / Produktet
Njohje Retroaktive	300	Për dite
Shpenzime të tjera shtesë	Kostot aktuale të tregut	Akomodim, shpenzime për ushqim, etj. për inspektorët
	3 % e shumës totale	Për çdo shtyrje të datës së caktuar të inspektimit

¹ Një ditë llogaritet një ditë pune prej 8 orësh pune.

² Shënim: Këto janë tarifat për shërbimet e Albinspekt. Për standartin Bio Suisse shërbimi i certifikimit sigurohet nga bio.inspecta. Në këtë rast, klienti do të marrë dy fatura: Albinspekt do të lëshojë një faturë për shërbimin e inspektimit ndërsa bio.inspecta do të faturojë shërbimin e certifikimit.

Tarifat për shërbimin e çertifikimit		
Standarti Organik i Albinspekt		
Çertifikimi	300	Për ditë
Çertifikata e produktit (për çdo certifikatë shtesë origjinale të kërkuar; përfshirë publikimin në faqen e internetit, lëshuar nga Albinspekt)	30	Për certifikatë
Lëshimi i Çertifikatës së inspektimit (transaksionit) (lëshuar nga Albinspekt)	300	Për ditë
bi-OS		
Çertifikimi	300	Për ditë
Çertifikata e produktit (për çdo certifikatë shtesë origjinale të kërkuar; përfshirë publikimin në faqen e internetit, lëshuar nga Albinspekt)	30	Për certifikatë
NOP		
Çertifikimi	300	Për ditë
Çertifikata e produktit (për çdo certifikatë shtesë origjinale të kërkuar; përfshirë publikimin në faqen e internetit, lëshuar nga Albinspekt)	30	Për certifikatë
Label fee	200	Për operator
Bio Suisse		
Çertifikimi	300	Për ditë
Label fee	100	Për operator
Administrim (aplikuar në totalin e faturës)	10 % e shumës totale	

Shënim: TVSH nuk është e përfshirë në tarifat e mësipërme.
Fatura e lëshuar për shërbimin lëshohet në monedhën "Lek" dhe "EUR".

Çertifikatat për bi-OS, NOP dhe Bio Suisse lëshohen nga bio.inspecta, por çmime lokale (sipas kësaj listë tarifash) ofrohen dhe faturohen nga Albinspekt bio.inspecta.

3. Tarifat për regjistrimin në Listën Pozitive të Albinspekt bio.inspecta

Tarifa për regjistrimin në listë do të konsistojë në:

- Tarifa e aplikimit për inputet 30'000 ALL. Listimi i inputit është i vlefshëm për 2 vite;
- Tarifa e aplikimit për farat dhe materialin mbjellës 30'000 ALL. Listimi i farave është i vlefshëm për 2 vite
- Rinovimi i listimit pas përfundimit të afatit 2 – vjekar për farat dhe inputet është 5000 ALL.
- Kosto të tjera shtesë:
 - Ditët e punës bazuar në tarifat e Albinspekt bio.inspecta (shih më lart),
 - Analiza laboratorike shtesë, etj sipas çmimit aktual të tregut.

4. Kosto të tjera

4.1 Inspektim shtesë

Nëse është e detyrueshme të kryhet inspektim shtesë (i lajmëruar apo i pa-lajmëruar) tarifat do të jenë në varësi të kohës së nevojshme dhe kostove (tarifa ditore plus shpenzimet e udhëtimit plus pagesat e analizave). Inspektimet shtesë kryhen duke u bazuar në shkallën e sanksioneve të dhëna nga certifikuesi, planifikimit të kryerjes së kontrolleve të mëtejshme të nevojshme për shkak të mospërputhjeve serioze me standardet përkatëse, dyshimeve për përdorime inputesh të palejuara, etj.

4.2 Marrja e kampioneve

Marrja e kampioneve do të tariforet sipas tarifave të përcaktuara në tabelat më sipër, sipas ditëve të punës së shpenzuara. Marrja e kampioneve realizohet në përputhje me politikën e Albinspekt bio.inspecta (në rast dyshimesh, në rast se kërkohet nga vetë klienti, etj).

4.3 Kosto shtesë

- **Për akomodimin, shpenzimet e udhëtimit** shkaktuar nga procesi i inspektimit (hoteli, bileta udhëtimi, dietat, etj);
- **Për shtyrjen e datës së inspektimit të rënë dakort:** sipas procedurave të Albinspekt bio.inspecta, data e inspektimit caktohet midis inspektorit dhe operatorit, përpara se të zhvillohet inspektimi. Në rastet kur kjo datë ndryshohet apo shtyhet, pa një justifikim të arsyeshëm, klienti do të faturohet me një shumë prej 3 % e shumës totale të ofertës së lëshuar.

4.4 Tarifa e tërheqjes

- Nëse klienti tërhiqet pas inspektimit, kostot e inspektimit dhe certifikimit të krijuar deri në momentin e tërheqjes do të paguhen.

4.5 Lëshimi i "Certifikatës së inspektimit për import" sipas Rregullores EEC 834/2007

Për çdo dërgesë produktesh të certifikuara si organike, në vendet e BE nevojitet një "certifikatë inspektimi" (ose ndryshe "certifikatë transaksioni"). Kjo certifikatë bën të mundur lëvizjen e lirë të produkteve brenda BE. Ju lutem kontaktoni me Albinspekt bio.inspecta për më tepër mbi procedurën e lëshimit të "Certifikatës së inspektimit". Tarifa e këtij shërbimi është përfshirë në pikën 2 të këtij dokumenti.

4.6 Apelimi i nje vendimi certifikimi

Cdo operator ka të drejtën të apelojë një vendim certifikimi nese nuk është dakort me të. Pagesat për apelimin do të jenë si më poshtë:

- 40'000 lek për tu paguar nga operatori nëse apelimi nuk pranohet nga Komiteti i Apelimt dhe vendimi i certifikimit nuk ndryshon.
- 20'000 lek për tu paguar nga operatori nëse apelimi pranohet pjesërisht nga Komiteti i Apelimt dhe vendimi i certifikimit ndryshon pjesërisht.
- Nëse apelimi pranohet plotësisht operatori nuk paguan.
- Nëse Komiteti i Apelimt vendos për kryerjen e verifikimeve / inspektimeve apo analizave shtesë kostot mbulohen nga operatori që ka apeluar vendimin.

5. Shërbime të tjera

Për çdo shërbim tjetër që Albinspekt bio.inspecta ofron, tarifa do të jetë **300 EUR për ditë pune**, pa përfshirë TVSH-në. Për më tepër informacion rreth shërbimeve të tjera ofruar nga Albinspekt bio.inspecta ju lutem vizitoni www.albinspekt.com.

6. Oferta për shërbimet³

Pas marrjes së kërkesës për inspektim/certifikim, Albinspekt i siguron klientit një ofertë për ofrimin e shërbimit të tij (e cila është e përshtatur me largësinë, madhësinë e njësisë, llojin e aktivitetit, etj).

- Në mënyrë që operatori të regjistrohet në sistem nevojitet parapagimi i vlerës 70 % të ofertës së dërguar.
- Albinspekt rezervon të drejtën të kërkojë parapagesën prej 100 % të ofertës në raste specifike.

Ju bëjmë me dije se kostot e shërbimit varen nga përgatitja e operatorit për procesin e inspektimit.

³ Shënim: Ju bëjmë me dije se oferta nuk reflekton koston totale të shërbimit. Oferta përdoret për të dhënë një kosto të përafërt të shërbimit.

7. Mënyra e pagesës

Pagesa do të kryhet në bazë të faturës së lëshuar nga Albinspekt.

- Shuma e faturës mund të ndryshojë nga oferta, duke reflektuar kostot reale.
- Pagesa totale ose pagesa e mbetur për shërbimin duhet të likuidohet brenda 30 ditësh nga marrja e faturës.
- Për çdo transfertë bankare që reflekton likuidimin e faturës së shërbimit, kostot e transfertës i faturohen klientit (dërguesit). Në rast se kostot e transfertës ndahen, në faturën pasardhëse të lëshuar nga Albinspekt, do të reflektohet diferenca.

8. Ndryshimet e listës së tarifave

Operatorit i bëhen të ditura ndryshimet e listës së tarifave në formë elektronike me email, faqe interneti ose në formë postare. Për versionin më të fundit të listës së tarifave vizitoni www.albinspekt.com.

Shënim: Ky dokument është i vlefshëm nga data 13.04.2021 deri në 31.12.2022. Albinspekt bio.inspecta rezervon të drejtën ta azhurnojë atë gjatë kësaj kohe.

Ju lutem përpara se të aplikoni për certifikim kontaktoni Albinspekt bio.inspecta për një version të azhurnuar.

Llogaria bankare e Albinspekt bio.inspecta është si më poshtë vijon:

Beneficiary / Përfituesi : ALBINSPEKT BIO.INSPECTA SHPK Banka Kombëtare Tregtare (BKT) IBAN EUR: AL55 2051 1313 0029 04CL PRCF EURA IBAN ALL: AL60 2051 1313 0029 04CL PRCL ALLT Albinspekt Acc Nr. 431 002 904 SWIFT CODE : NCBAALTX BIC CODE : 20511021
